VENDIM
Nr. 388, datë 30.6.2021

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohet individi i renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT, SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA:

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida":

Mohammad Ali al Habbo

Shënim. Gjenealitet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.